V E N D I M
Nr.395, datë 20.5.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.186, DATË 18.3.1996 "PËR SHPEJTIMIN E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE TË PRIVATIZUARA"

Me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.186, datë 18.3.1996, në kreun I, në pikën 4, paragrafi i dytë shfuqizohet, kurse në paragrafin e parë, fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

"Kur nuk ka asnjë mundësi shitjeje, të bëhet braktisja e tyre me vendim të organit në vartësi e administrim të të cilit është objekt ose mjetet përkatëse. Agjencia Kombëtare e Privatizimit ose dega e saj, sipas vartësisë së pasurisë që do të publikohet për shitje, mban një procesverbal të procedurës së privatizimit dhe ia dërgon organit që do të marrë vendim. Procesverbali duhet të përmbajë procedurën e ndjekur nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit ose dega e saj për privatizimin e objekteve ose të mjeteve përkatëse.

Privatizimi i objekteve ose i mjeteve përkatëse bëhet sipas këtij vendimi, duke u bërë publikimi i tyre në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.203, datë 3.5.1995, dhe, në rast se nuk ka kërkesa, jo më pak se dy cikle publikimi."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi